



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**VENDIM**

**K.P.P. 416/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.10.2020, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dajt Park 2007” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-58423-05-18-2020 me objekt: Loti 7 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartet Ushtarake nr. 1040, 1050 (Forcat Tokësore)”, me fond limit 127,325,733 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.07.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** “Dajt Park 2007” sh.p.k.  
Lagja “Qesarake”, godinë banimi dhe shërbimesh 3, 4 kate + nëncati + 2 kate bodrum, kati I, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë

**Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.05.2020, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me nr. REF-58423-05-18-2020 me objekt: Loti 7 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartet Ushtarake nr. 1040, 1050 (Forcat Tokësore)”, me fond limit 127,325,733 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.07.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 20.07.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor në datë 31.07.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                              |                                |
|------------------------------|--------------------------------|
| 1. “Sinani Trading” sh.p.k.  | 0.00 lekë, Skualifikuar;       |
| 2. “Dajti Park 2007” sh.p.k. | 91.248.000 lekë, skualifikuar; |
| 3. “Dion AI” sh.p.k.         | 126.924.000lekë, kualifikuar;  |

II.4. Në datën 31.07.2020 operatori ekonomik “Dajt Park 2007” sh.p.k., është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

*Operatori Ekonomik “Dajti Park 2007” shpk, nuk plotëson nën pikën 1, të seksionit 3.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, sipas të cilit Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit, pasi Operatori “Dajti Park 2007” shpk, në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë dëshmi për shërbimet e*

mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Në faturat nr. 56 datë 21.12.2019 dhe nr. 49 datë 31.03.2020, nuk përcaktohen sasisë e shërbimit të ofruar. Operatori ekonomik, këto fatura nuk i ka shoqëruar as me kuponat e kasës.

II.5. Në datën 07.08.2020 operatori ekonomik "Dajt Park 2007" sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon:

"Autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Perqendruara, më datë 20/05/2020 ka publikuar në sistemin elektronik të APP procedurën REF-58423-05-18-2020 e objekt "Loti 7 Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartet Ushtarake nr. 1040, 1050 (Forcat Tokësore)", me a/at të dorëzimit të ofertave datën 17/07/2020. Shoqëria jone paraqiti oferte në lidhje me këtë procedurë. Më datë 31/07/2020, autoriteti kontraktor publikoi në sistemin elektronik renditjen e operatoreve pjesëmarrës, e cila rezultoi si më poshtë:

"Sinani Trading" sh.p.k.	0.00 lekë, Skualifikuar;
"Dajti Park 2007" sh.p.k.	91.248.000 lekë, skualifikuar;
"Dion Al" sh.p.k.	126.924.000lekë, skualifikuar;

S'kualifikimi i shoqërisë tone shoqërohet me arsyetimin se:

Operatori Ekonomik "Dajti Park 2007" shpk, nuk plotëson nën pikën 1, të seksionit 3.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, sipas të cilit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit, pasi Operatori "Dajti Park 2007" shpk, në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Në faturat nr. 56 datë 21.12.2019 dhe nr. 49 datë 31.03.2020, nuk përcaktohen sasisë e shërbimit të ofruar. Operatori ekonomik, këto fatura nuk i ka shoqëruar as me kuponat e kasës.

Ne analizuam me kujdes klasifikimin e operatoreve ekonomike dhe gjykojmë se ai është teresisht i padrejte dhe i pabazuar për arsyet si më poshtë:

Pike se pari, nepërmjet shkresës Nr 1500 prot, dt 24/07/2020 me përshkrimin "Informacion për oferte anomalisht të ulet", Komisioni i Vlerësimit të Ofertave na kërkon shpjegim për ofertën tone e cila ka rezultuar anomalisht e ulet.

Ne përgjigje të kërkesës së mesipërme, brenda afatëve kohore me dt 27/07/2020, kemi dërguar nepërmjet sistemit elektronik dhe protokollit shpjegimet tona në lidhje me ofertën anomalisht të ulet.

Ne respektojmë të kërkesës së KVO për dërgimin e argumentimit brenda afatit të përcaktuar, kemi angazhur një staf prej 5 personash specialiste të fushës për argumentimin e ofertës anomalisht të ulet.

Neni 66 pika 4 dhe pika 5 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 shprehet se:

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

"Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se  $\pm 2\%$  e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.

Nëse pas kërkesës së komisionit të vlerësimit të ofertave, ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

*Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

*- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit tëpërlllogaritur.*

*- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave tëvlefshme.*

*Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.*

*Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe tëdokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.*

*Referuar nenit 66 pika 4 dhe pika 5 te VKM Nr. 914, date 29.12.2014 te siperpermendur, percaktohet se:*

*Kerkesa per argumentimin anomalisht te ulet i kerkohet ofertave te kualifikuara, te cilat fillimisht verifikohen nese perrnbajne ose jo gabime aritmetike.*

*Shoqeria Dajti Park 2007 nuk ndodhet ne kushtet e ofertes me gabime aritmetike.*

*Referuar sa me siper, per sa kohe KVO na ka kerkuar shpjegim per oferten anomalisht te ulet, ka rezultuar se oferta jone eshte e kualifikuar dhe ploteson te gjitha kerkesat e DST.*

*Rrjedhimisht s'kualifikimi i shoqerise Dajti Park 2007 per arsye te ndryshme nga argumentimi i ofertes anomalisht te ulet pas dergimit te Kerkeses per oferte anomalisht te ulet dhe pas dergimit te shpjegimeve nga ana jone, eshte teresisht i paligjshem dhe ne kundershtrim me ligjet dhe VKM ne fuqi.*

*Ky s'kualifikim cenon ne thelb jo vetem garancite procedurale te operatoreve ekonomike pjesemarres, por njeherazi cenon edhe parimin e sigurise juridike. Ne jurisprudencen e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikes se Shqiperise ne vendimin nr. 12/2014 date 17.03.2014 eshte shprehur se "Siguria juridike nenkupton, ndermjet te tjerash, garantimin e besueshmerise se individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet qe ato nxjerrin".*

*Ne rastin konkret parimi i sigurise juridike ne kuptimin material te tij, konsiderohet edhe moscenimi i te drejtave te fituara dhe i pritshmerive te ligjshme qe garantojne aktet ne fuqi. Akoma me tej, ne jurisprudencen e saj, Gjykata Kushtetuese Inter Allia ne vendimin 15/2010 ka theksuar se "parimi i shtetit te se drejtes i sanksionuar ne nenin 4 te Kushtetutes nenkupton veprimin e te gjitha institucioneve shteterore sipas se drejtes ne fuqi si dhe supremacine e Kushtetutes ndaj akteve te tjera normative. Cdo organ ne nje shtet te se drejtes duhet te veproje per aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkalar kufijte e percaktuar prej tyre. Ne kete kuptim, cdo institucion shteteror duhet te kete te percaktuar qarte fushen e kompetencave te veta hrenda te cilave eshte i autorizuar te veproje ne perputhje me kerkesat kushtetuese dhe ligjore".*

*Ne lidhje me arsyen e s'kualifikimit sqarojme se faturat e paraqitura prej nesh Nr 56 dt 31/12/2019 dhe Nr 49 dt 31/03/2020 jane mese te rregullta dhe te deklaruar prane organeve tatimore (bashkelidhur gjeni librat e shitjes). Ato pasqyrojne ne menyre reale dhe te qarte pervojen e ngjashme me objektin e ketij prokurimi.*

*Per sa me siper argurnentuar, kerkojrne pezullimin e vazhdimit te procedures dhe kualifikimin e ofertes se shoqerise tone, si oferte qe ploteson te gjitha kerkesat e DST dhe me efekt te konsiderueshem prej 35676000 (tridhjetë e pese milione e gjashtëqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë) leke pa tvsh per buxhetin e shtetit.[...].”*

II.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimes si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr1571/3 prot, datë 13.08.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., duke e refuzuar atë me pretendimin si më poshtë:

*[...]Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e here ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se: Per ofertuesin "Dajti Park 2007" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 31.07.2020, arsyet e skualifikimin te ofertes se tij si vijon:Operatori Ekonomik "Dajti Park 2007" shpk, nuk plotëson nën pikën 1, të seksionit 3.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, sipas të cilit Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit, pasi Operatori "Dajti Park 2007" shpk, në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Në faturat nr. 56 datë 21.12.2019 dhe nr. 49 datë 31.03.2020, nuk përcaktohen sasitë e shërbimit të ofruar. Operatori ekonomik, këto fatura nuk i ka shoqëruar as me kuponat e kasës.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacioni e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK dhe konstatoi:*

*Ne dokumentat e tenderit ne shtojcen nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 1 percaktohet se operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per sherbimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit te lotit. Realizimi i sherbimeve te ngjashme duhet te vertetohet me dokumentacionin si me poshte: Kur per sherbimet e ngjashme jane realizuar me institucione shteterore, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetimin e Ieshuar nga institucioni shteteror per realizimin e sherbimeve ose faturat tatimore te shitjes; Kur per sherbimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturat perkatese tatimore te shitjes ku te jene shenuar datat, shumat dhe sasite e sherbimeve te fumizuara.*

*Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne shtojcen nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 1 ka paraqitur vertetime te Ieshuar nga institucione shteterore per realizimin e sherbimeve dhe fatura tatimore. Nder faturat tatimore te paraqitura nga ofertuesi "Dajti Park 2007" sh.p.k. janë dhe fatura tatimore nr. 56 datë 31.12.2019 si dhe fatura taimore nr. 49 datë 31.03.2020.*

*Nga verifikimi rezulton se faturat tatimore nr. 56 date 31.12.2019 dhe fatura tatimore nr. 49 date 31.03.2020 nuk permbajne sasine e sherbimeve te fumizuara si nje nga elementet e domosdoshern te fatures ashtu sikurse eshte percaktuar ne dokumentet e tenderit.*

*Ne dokumentat e tenderit ne shtojcen nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 1 percaktohet se per sherbimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturat perkatese tatimore te shitjes ku te jene shenuar datat, shumat dhe sasite e sherbimeve te furnizuara.*

*Sa me siper, bazuar ne ligjin nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar neni 53, pika 3 ku percaktohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji. ", organi qendror bleres ka bere skualifikimin e ofertuesit "Dajti Park 2007" SHPK.*

*Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit "Dajti Park 2007" SHPK nuk pranohet.*

*Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organit qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me nenin 63, pika 6, te LPP. [...]*

II.7. Në datën 17.08.2020, operatori ekonomik ankimues “Dajt Park 2007” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.8. Në datën 27.08.2020, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1640/1prot. datë 25.08.2020, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të ankimuesit,

#### **Arsyeton:**

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të ankimuesve, në zbatim të nenit 30, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, nisur nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga arsyet e skualifikimit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, këto kriterë janë hartuar në kundërshtim me legjilacionin në fuqi, pasi shkaktojnë konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht vëren se:

III.1.2. Në shtojcën 8, “Kapaciteti teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor, ndër të tjera ka vendosur kriteret si më poshtë vijon:

*“1.Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per shërbimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit të lotit. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:*

•Kur per shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes.

•Kur per shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 28 pika 3 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: Dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.1.5. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vecantë të vendosur. Lidhur me eksperiencat e ngjashme të shërbimeve/punëve publike apo mallrave, konstatojmë se në rastin konkret në nenin 28 pika 3 “Kontratat e Shërbimeve”, të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “[...]Dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.[...]”, ndërsa në kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi parashikohet se: “[...]Kur per shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për

*realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes. Kur per shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.[..].”*. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në formulimin e këtij kriteri autoriteti kontraktor ka devijuar nga përcaktimi i këtij të fundit në kundërshtim me nenin 28 pika 3 “Kontratat e Shërbimeve”, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar pasi vet legjislacioni në fuqi përcakton dëshmi, fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara ndërsa në kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të kishte përcaktuar kriterin në bazë të legjislacionit në fuqi dhe jo duke bërë devijime në përcaktimin e kriterëve në mënyrë që të identifikohen e lehtësisht dhe që të krijohet panoramë e qartë mbi kapacitetet e kërkuara, të mos krijohet konfuzion si tek operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ashtu edhe tek anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave gjatë procesit të shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave, si dhe duke mos krijuar hapësirë për vlerësim subjektiv. Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.5. Sa më lart, gjykojmë se kriteret e mësipërme, nuk janë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, pasi hartimi i kriterëve në këtë mënyrë krijon konfuzion, si tek operatorët ekonomikë, ashtu edhe tek komisioni i vlerësimit të ofertave për vlerësimin e tyre, si edhe nuk krijon një panoramë të qartë të autoritetit kontraktor mbi kapacitetet e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, detyrim ligjor që rrjedh nga zbatimi i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Sa më sipër, në kushtet kur konstatohet se kriteret për kualifikim janë hartuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, situata e tillë përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit.

III.1.6. Kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qënë pjesëmarrës, komisionin e vlerësimit të ofertave në mënyrë të tillë që procesi i vlerësimit të mos kryhet me subjektivizëm, por të vendosë në situatë të barabartë edhe personat me aftësi të kufizuara, duke mos penguar kështu pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen në mënyrë që autoriteti kontraktor të krijojë një panoramë të qartë mbi kapacitetet ekonomikë – financiare, tekniko – profesionale dhe eksperiencën e operatorëve ekonomikë që janë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, përcaktimi i kriterëve për kualifikim, së pari, janë të paqartë, dhe së dyti, nuk janë në frymën e legjislacionin për prokurimin publik i cili kërkon që të përcaktohen saktë termat, emërtimet apo specifikimet teknike dhe në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

III.1.7. Bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP – së, si dhe në nenin 31, pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e



*kontratës fituese dhe të udhëzohë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se situata konfuze e krijuar nga mospërcaktimi i qartë i kriterëve për kualifikim, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi, si rrjedhojë e kriterëve evazive dhe të hartuara jo në përputhje me nenin 28/2 të VKM 914/2014, mbi të cilat KVO ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim në themel, pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet për shkaqet e sipërcituara*

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos:**

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dajt Park 2007” sh.p.k., për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me nr. REF-58423-05-18-2020 me objekt: Loti 7 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartet Ushtarake nr. 1040, 1050 (Forcat Tokësore)”, me fond limit 127,325,733 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.07.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulohë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dajt Park 2007” sh.p.k.,
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 968 protokoli Datë 17.08.2020;**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**

**Enkeleda Bega**

**Anëtar**

**Lindita Skeja**

**Anëtar**

**Merita Zeqaj**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**